



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 13.5.2023

Nr: 517

Ora: 20:00

VENDIM

PËR

**PAJISJEN E QENDRËS SË POSAÇME TË VOTIMIT NR.1967/01 KZAZ NR.39, BASHKIA TIRANË,
ME SASINË SHITESË TË FLETËVE TË VOTIMIT, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES
VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të nenit 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr.10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale “Jordan Misja”, me shkresën nr. 1656, datë 12.05.2023, me objekt “Kërkesë për fletë të votimit”, i ka propozuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të pajisë I.E.V.P “Jordan Misja” me sasinë shtesë të fletëve të votimit për dhënien e të drejtës për të votuar personave të paraburgosur, të cilët kanë të drejtë vote por nuk figurojnë në listën përfundimtare të zgjedhësve të kësaj qendre votimi të posaçme.

Shtetasit të cilët vuajnë dënimin në këtë institucion kanë fituar të drejtën për të votuar në Qendrën e Votimit nr. 1967/01, KZAZ nr. 39, Bashkia Tiranë, sipas vendimit të gjykatës.

Në këto kushte, KQZ duhet të marrë masa të sigurojë sasi shtesë të fletëve të votimit për të mundësuar votimin e shtetasve të sipërcituar.

PËR KËTO ARSYE;

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, nenit 43, nenit 62, pika 2, nenit 93, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Data: 13.5.2023 Nr: 517
Ora: 20:00



“Për pajisjen e Qendrës së Posaçme të Votimit nr. 1967/01 KZAZ nr. 39, Bashkia Tiranë, me sasinë shtesë të fletëve të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

V E N D O S:

1. Autorizimin e KZAZ-së nr. 39, Bashkia Tiranë, që të pajisë me 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë votimi për kandidatët për kryetar bashkie dhe 260 (dyqind e gjashtëdhjetë) fletë votimi për Këshillin e Bashkisë, Qendrën e Votimit të Posaçme nr. 1967/01.
2. Sasia shtesë e fletëve të votimit do të merret nga qendrat e votimit nr. 1957, nr. 1957/1, nr.1957/2, nr. 1958 dhe nr. 1958/1, të Njesisë Administrative nr. 9, respektivisht, nga 52 (pesëdhjetë e dy) fletë votimi për kandidatët për kryetar bashkie dhe 52 (pesëdhjetë e dy) fletë votimi për Këshillin e Bashkisë, nga secila qendër votimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI